



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.591/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Adnan Konushevci kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Mergime Krasniqi nga Zvicra, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 02.09.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET i palejuar apeli Anr.591/2021 i paraqitur nga Mergime Krasniqi me vendbanim në Zvicër, me të cilin kërkon që ti përmirësohet mbiemri në listën e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

A r s y e t i m

Me datën 01.09.2021 PZAP-i, ka pranuar një apel nga nga Mergime Krasniqi me vendbanim në Zvicër në të cilin pretendon se edhe pse e njëjta gjendet në listën e votuesve jashtë Kosovës me mbiemrin e vajzërisë Fanaj dhe atë në listën votuese për Komunën e Prizrenit, në momentin e aplikimit ka bashkangjitur dëshmi se e njëjta ka ndërruar mbiemrin në Krasniqi dhe ka të drejtë votimi në Komunën e Junikut. E njëjta kërkon që ti lejohet të votoj në këtë komunë.

Apelit ja ka bashkangjitur formularin e aplikimit për votim jashtë Kosovës dhe pasaportën e Kosovës.

Me datë 01.09.2021 PZAP, ka parashtruar kërkesë për përgjigje pranë KQZ, me të cilën ka kërkuar që të njoftohet lidhur me apelin e parashtruar nga pala ankuese deri me datë 01.09.2021 në ora 18:00.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve brenda afatit kohor ka paraqitur përgjigje në kërkesë në të cilën ka theksuar se Mergime Krasniqi është në listën votuese jashtë Kosovës. Arsyeja se pse ankuesja nuk e ka gjetur emrin në listën e votuesve është se në këtë listë në vend të mbiemrit Krasniqi është shkruar mbiemri Fanaj gjatë procesit të futjes se të dhënave në data bazë. Ndërsa të dhënat e tjera në tërësi janë të Mergime Krasniqit. Pra, ky gabim do të korrektohet.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimit e apelimit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Parashtrueses së Apelit i mungon interesi juridik

Me datë 01.09.2021 Mergime Krasniqi ka parashtruar në PZAP apel ndaj KQZ-së, për mos përfshirje në listën e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të datës 17.10.2021.

PZAP ankesën e ankuesit e trajton si apel meqenëse ndaj vendimeve të KQZ palët e interesuar mund të parashtrojnë Apel.

Me rastin e shqyrtimit të Apelit PZAP iu ka drejtuar KQZ për të dhënë përgjigje në raport me apelin e parashtrueses dhe pretendimeve që dalin nga i njëjti.

KQZ-ja me anë të përgjigjes në apel dërguar në PZAP ka konfirmuar se parashtruesja e apelit gjendet në listën e votuesve, mirëpo ka ndodhur një gabim gjatë futjes së të dhënave në data bazë ku në vend të mbiemrit Krasniqi është shkruar mbiemri Fanaj, ku dhe kanë deklaruar se ky gabim do të korrektohet.

PZAP duke vlerësuar apelin e personit në fjalë vlerëson se në rastin konkret të njëjtës i mungon interesi juridik për parashtrimin e apelit meqenëse e njëjta është e përfshirë në listën e votuesve.

Prandaj PZAP-i, mbi këtë baze dhe nga arsyet e sipërsënuar dhe në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.591/2021 më datën 02.09.2021

Kryesuesi i Panelit
Adnan Konushevi

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.